



Ekrem Beqiri (1944-2008)

Organizimi i Simpoziumit Ekrem Beqiri, në kuadër të Konferencës së Inxhinierisë dhe TI, Takimi i VII, IASH 2012, ka si qëllim që sado pak të nderojmë punën dhe veprën e prof. Dr. Ekrem Beqiri. Por më këtë aktivitet ne do të nderojmë seksionin e inxhinierisë së IASH-it, prezantuesit në këtë simpozium (40 punime më 104 autorë) dhe shkencat inxhinierike në përgjithësi. Të gjithë që e njohëm profesorin Ekrem do të na kujtohet çdo herë si njeri modest, i afërt, i vendosur, më zemër të madhe. Çdo paraqitje e tij në takime profesionale dhe shkencore ishte në nivelin të cilin vetëm ai dinte ta ndërtojë më përgjegjësin e madhe për fjalën e thënë dhe të shkruar. Dr. sc. Ekrem Beqiri është i lindur në Pejë, më 10 mars 1944 dhe vdiq më 31.07.2008 në Prishtinë. Shkollën tetëvjeçare dhe Gjymnazin i kreu në Pejë (1962), studimet universitare (1968) dhe pasuniversitare (1972) në FTM në Universitetin e Beogradit. Në FTM në Beograd mori tezën e doktoratës në vitin 1982. Në vitin 1968 punësohet në ShLT në Mitrovicë, dhe në ShLE në Pejë si asistentit, dhe në thirrje të profesorit të shkollës së lartë. Që nga viti 1972 është angazhuar në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, ku në vitin 1983 zgjidhet në thirrje të docentit për lëndën “Operacionet teknologjike”. Gjatë viti 1986-87 punon edhe si drejtor i Institutit pranë FXM-së në Mitrovicë. Në vitin 1988 zgjidhet në thirrjen e profesorit inordinar dhe në vitin 1999 zgjidhet profesor ordinar. Ligjërata nga kjo fushë ka mbajtur në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (Prishtinë) dhe në Universitetin RIINVEST. Prof. Ekrem, kështu e thërrisim të gjithë nga respekti, sepse e meritonte atë thirrje më të gjitha elementet e një intelektuali të mirëfilltë, ishte një profesionist i madh i fushës së inxhinierisë kimike ku la pas veti një biografi të pasur, gjashtë libra universitare: “Operacionet difuzive” (1988); “Operacionet teknologjike”, I-II (1977-1999); “Kursi i lartë i transmetimit të nxehtësisë” (1966); “Rrymimi turbulent i fluidit të shtypshëm” (1997), mbi pesëdhjetë punime të publikuara në revistat shkencore, dhe pjesëmarrje në shumë simpoziume, konferenca, dhe kongrese në vend, rajon dhe botë. Dr. sc. Ekrem Beqiri ishte aktiv edhe në fushëveprimet tjera, ku trajton dukurit e ndryshme të jetës shoqërore dhe politike të Kosovës (revista Alternativa, Republika, dhe Forumi). Është njeri ndër themeluesit e Komitetit Kosovar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe nënkryetar i këtij komiteti, Kryetar i Bordit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur, nënkryetar i Institutit “Riinvest”. Është autor i logos së: Qeverisë së Kosovës, Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Asociacionit të Teknologëve dhe Metalurgëve të Kosovës, etj. Dr. sc. Ekrem Beqiri ka punuar si menaxher në disa dhjetëra projekte: “Kosovo Early Warning Reports with in an important project related to political stability, economic stability, inter-ethnic relations and public security”, “Assistance to the Anti-Corruption Agency of Kosova”, “ESTAP III – Mining Sector Community Participation and Development Plan”, “Empowerment social dialogue in Mining and Industry”, etj. Në vitin 1966, nëpërmes IASTE qëndron dy muaj në Poloni, në Institutin e Fakultetit Politeknik në Napoli (viti 1974) qëndron gjashtë muaj, dhe gjashtë muaj të tjerë si student i Programit Fulbright pranë Institutit Politeknik “Rensselaer” në SHBA.